

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhment Financiar
(zgjidhjet)

P7

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI

Data 06.07.2024

Problemi 1

Arta është kopësht i fëmijëve. Është biznes profitabil dhe kërkesa për vende të lira në kopshte gjithmonë tejkalon ofertën për shkak të numrit të kufizuar të këtyre institucioneve. Pronare dhe menaxhere e kopshtit është zonja Arta. i gjithë stafi në kopësht janë ose familjarë ose miq të mirë të zonjës Arta, dhe bile edhe stafi që ka punuar më së shkurti në këtë institucion është aty tashmë 10 vite. Arta është duke planifikuar të pensionohet kur ti mbushë 60 vjet, që do të ndodhë pas 6 viteve, në të cilin moment ajo planifikon të shet këtë biznes njërit ose disave nga stafi ekzistues.

Ajo planifikon të punojë me orar të plotë deri sa të pensionohet. Aktualisht është duke konsideruar të zgjerojë ndërtesën për të krijuar më shumë hapësirë në mënyrë që të përmbushë kërkesat për vende në kopësht. Vëllau i Artës i ka ofruar që ta punojë vetë këtë zgjerim me një çmim shumë konkurrues. Aktualisht ai është i papunë dhe do të falimentojë shumë shpejtë nëse nuk gjen punë. Zonja Arta parashikon, që së bashku me këtë zgjerim, do ta shes biznesin për €600,000 pas 6 vitesh.

Nëse nuk e zgjeron ndërtesën, ajo do të mund ta shes biznesin €500,000 pas 6 viteve. Një ndërtues rishtas ia ofroi Znj Arta ta blente ndërtesën tani për €850,000. Ai shpreson të ndërtojë apartmante në këtë tokë.

Zonja Arta duhet të vendosë nëse të vazhdojë biznesin pa zgjerim (Opsioni 1), ta zgjerojë ndërtesën (Opsioni 2), ose ta shes tani ndërtesën (Opsioni 3). Ju i keni në dispozicion informatat në vijim:

1. Znj Arta tashmë e ka marrë lejen e ndërtimit për zgjerim të ndërtesës në vlerë prej €1,200.
2. Kosto e ndërtimit të zgjerimit/shtesës vlerësohet të jetë €85,000. Nga kjo shumë, €45,000 ka të bëjë me materialet të cilat duhet të paguhen menjëherë. Pjesa e mbetur është puna e ndërtimit e cila do të paguhet pas përfundimit të ndërtimit. Vlerësohet se ndërtimi do të zgjasë 1 vit. Gjatë ndërtimit, kopshti do të jetë i hapur dhe nuk do të ndikohet nga punët ndërtimore.
3. Kopshti aktualisht gjeneron rrjedhë neto të parasë në vlerë prej €98,000 në vit. Me zgjerimin, kjo do të rritej në €135,000 pasi të ndërtohej. Znj Arta i paguan vetes një pagë, dhe kjo shumë tashmë është zbritur për të arritur në shumën prej €98,000.
4. Kosto e kapitalit të këtij biznesi është 10% vjetore.
5. Supozoni se rrjedha e parasë ndodhë në fund të secilit vit, përveç nëse thuhet ndryshe.

Tabela e faktorëve të me 10%

Viti	Faktori
1	0.909
2	0.826
3	0.751
4	0.683
5	0.621
6	0.564

Tabela e faktorëve skontues të anuiteteve me 10%

Viti	Faktori
1	0.909
2	1.736
3	2.487
4	3.170
5	3.791
6	4.355

Kërkohet:

- a. Duke përdorur tabelat e skontimit, llogaritni vlerën neto të tanishme (VTN) për secilin opsion sipas kostos së kapitalit të biznesit. Bazuar në këto llogaritje, tregoni se cilin opsion duhet ta zgjedhë Znj Arta. 20 Pikë
- b. Tregoni katër faktorë jo-financiar që duhet të merr parasysh Arta para se të merr vendimin përfundimtar 5 Pikë

(Totali: 25 pikë)

Zgjidhja - 1

(a)

Opsioni 1: Vazhdimi me biznes - pensionimi pas 6 viteve - pa zgjerim								
	VT €	Vitet	Anuiteti	Faktori i skontimit	VNT €			
Rrjedha neto	98,000	6	4.355		426,790			
Të hyrat nga shitja	500,000	6		0.564	282,000			
					708,790			
Opsioni 2: Zgjerimi i ndërtesës - shitet pas 6 viteve kur pensionohet								
Vitet	0	1	2	3	4	5	6	
Leja e ndërtimit (injoro - kosto që fundoset)								
Kosto e ndërtimit: Materialet	-45,000							
Kosto e ndërtimit: Puna		-40,000						
Hyrjet e parasë nga aktivitetet operative		98,000	135,000	135,000	135,000	135,000	135,000	
Çmimi shitës							600,000	
Rrjedha neto e parasë	-45,000	58,000	135,000	135,000	135,000	135,000	735,000	
Faktori i skontimit/ Anuiteti	1.000	0.909	0.826	0.751	0.683	0.621	0.564	
VNT	-45,000	52,722	111,510	101,385	92,205	83,835	414,540	811,197
Opsioni 3: Shite tani								
Vitet	0							
Të hyra nga shitja	850,000							
Faktori skontues	1.000							

VNT	850,000							
Vlera më e lartë është sipas opsionit 3								

(b) Faktorët tjerë që duhet të konsiderohen:

- Nëse Arta e zgjeron ndërtesën ajo do ti ofrojë punë vëllaut të saj dhe ta ndalojë ata nga falimentimi.
- Zgjerimi do të ofrojë hapësirë të shumë kërkuar për fëmijët e lagjes.
- Zgjerimi do të mundësoj Artën të vazhdojë punën, pasi që ajo dëshiron të punojë deri në pensionim.
- Stafi po ashtu mund ta humb punën nës Arta e shet ndërtesën tani.
- Ndërtimi mund të shkaktojë zhurmë dhe problem me kopshtin.
- Çfardo arsye tjetër që mbështetet me fakte

Problemi 2

Fair është një kompani e listuara cila është e specializuar në prodhimin dhe shpërndarjen e mobiljeve të rrugës të tilla si banka, ulëse, shtylla postimi. Menaxhmenti është duke marrë parasysh zgjerimin e gamës së tyre në prodhimin dhe instalimin e llambave rrugore. Kjo padyshim do të kërkojë një investim të konsiderueshëm dhe ata janë duke kërkuar mënyra për të financuar këtë.

Kërkohet:

Shpjegoni:

- | | |
|--|----------------|
| (a) avantazhet dhe disavantazhet, për një kompani, të financimit me borxh në vend të financimit me kapital; | 10 pikë |
| (b) arsyet përse një kompani mund të zgjidh të lëshojë aksione preferenciale në vend të aksioneve të zakonshme ose të borxhit; | 5 pikë |
| (c) qëllimin e një plan biznesi. Përdorni shembuj nga bizneset e reja dhe të themeluara më herët për të ilustruar përgjigjen tuaj | 10 pikë |

(Totali: 25 pikë)

Zgjidhje - 2

(a)

Avantazhet e financimit me borxh

- Lëshimi i borxhit nuk ndikon në pronësinë dhe kontrollin e kompanisë sepse mbajtësit e borxhit nuk janë pronarë të kompanisë
- Financimi përmes borxhit është më i lirë se financimi përmes ekuitetit. Kjo është për shkak se është më me pak rrezik për huadhënësin dhe e dyta interesi në borxh është i zbritshëm për qëllime të tatimit deri sa dividendat nuk janë
- Lëshimi i borxhit relativisht është i lirë krahasuar me lëshimi e aksioneve.
- Është më lehtë të arranzhohet financimi përmes borxhit se sa përmes ekuitetit. Kompanitë që janë të listuara në bursë duhet të plotësojnë kushte strikte nga bursat dhe zakonisht kjo merr kohë.

Disavantazhet e financimit përmes borxhit

- Me rritjen e nivelit të borxhit me secilin lëshim të ri të borxhit, niveli i kostos së ekuitetit do të rritet për të reflektuar rritjen e rrezikut financiar të kompanisë.
- Borxhi, për dallim nga ekuiteti, duhet të paguhet në fund të periudhës së dakorduar. Kjo mund të shkaktojë vështirësi financiare për kompaninë nëse kanë fonde të pamjaftueshme. Nëse kompania nuk e paguan borxhin mund të ballafaqohet me rrezikun e bakrotimit.
- Interesi DUHET të paguhet për borxhin për deri sa pagesat e dividendës në aksionet e zakonshme janë sipas marrëveshjes.
- Nëse kompania ka marrë borxh me normë interesi të luhatshme, kompania i nënshtrohet rrezikut të normës së interesit. Kjo do të thotë se shpenzimi i interesit do të rritet nëse norma e interesit në treg rritet.
- Zakonisht kërkohet kolateral për hua/borxhe. Kjo mund të pengojë kompaninë nga përdorimi i disa pasurive që i ka lënë kolateral.
- Marrëveshjet për hua mund t'i nënshtrohen kushteve restrictive, psh nga kompania kërkohet të mbajë nivel të caktuar të koeficientit qarkullues etj.

(b)

Arsyet për emetimin e aksioneve preferenciale

- Aksionet preferenciale nuk kanë të drejtë vote. Kjo do të thotë se nuk i japin blerësit ndonjë kontrollë mbi vendimet e kompanisë. Prandaj emetimi i tyre nuk e ndryshon kontrollin.
- Kapitali i aksioneve preferenciale nuk sigurohet përmes ndonjë kolaterali siç është rasti me huatë.
- Dividendat nga aksionet preferenciale nuk ka nevojë të paguhen nga kompania nëse kompania nuk ka para, edhe pse këto dividend e kanë të drejtën për dividenda kumulative, dividend që barten nga viti në vit.
- Aksionet preferenciale pa të drejtë të ri-blerjes e ulin koeficientin e borxhit ndaj ekuitetit të një kompanie, që zakonisht shihet si një gjë e mirë. Mirëpo, aksionet preferenciale të ri-bleshme zakonisht trajtohen si borxh për qëllim të llogaritjes së koeficientit të borxhit ndaj ekuitetit, prandaj e rrisin këtë koeficient.

(c) një biznes plan është process i identifikimit, analizimit dhe përzgjedhjes së porjekteve investuese për të cilat kthimi në investim pritet të jetë më i gjatë se një vit.

Plani i biznesit do të përgatitet për të mbuluar periudha më të gjata se shitjet, prodhimi dhe buxheti i burimeve, në mënyrë tipike për 3 deri 5 vjet edhe pse duhet të jetë i ndarë në periudha vjetore. Plani duhet të tregojë shpenzimet që kërkohen për të mbuluar projektet kapitale që janë në vijim dhe ato të parashikuarat që do të fillojnë në periudhën 3-5 vjet.

Arsyeja e krijimit të një plani të biznesit:

Gjatë themelimi të kompanisë:

- Për të treguar qëndrueshmërinë e projektit
- Tërheqja e investuesve
- Gjetja e profitabilitetit
- Vlerësimi i nevojave financiare

Për zhvillimet në të ardhmen

- Aktivitetet e reja
- Strategjitë e reja
- Blerjet e kompanive
- Projekte të përbashkët ose marrëveshje tregtare me kompani tjera
- Investimet e rëndësishme dhe kryesore

Mbështetja e planeve afatmesme

- Mbështetja e strategjisë
- Arsyetimi i caqeve të rritura të aktivitetit
- Kontrollimi i planve të veprimit të departamenteve

Në fund, plani i biznesit është mjet menaxherial me caqet në vijim:

- Koncesunsi i kompanisë për të ardhmen
- Monitorimi i vazhdueshëm në mes të vendimeve dhe objektivave
- Përcaktimi i objektivave afatmesme
- Përcaktimi i dobësive dhe përparësive
- Validimi i treguesve të rezultateve
- Matja e rreziqeve potenciale të kompanisë

Problemi 3

(a) Raph Ltd ka një kosto oportune 12% të fondeve dhe aktualisht shet me kushte neto 10 EOM (në fund të muajit 'endo of month'). Firma ka shitje prej 10,000,000 € në vit, të cilat janë 80% me kredi dhe shpërndahen në mënyrë të barabartë gjatë vitit.

Aktualisht, periudha mesatare e grumbullimit është gjashtëdhjetë (60) ditë. Nëse firma do të ofronte kushte prej 2/10, net 30, 60% e klientëve të saj do të merrnin zbritjen dhe periudha e grumbullimit do të reduktohej në dyzet (40) ditë.

Kërkohet:

A duhet të ndryshojë kushtet e tij nga net/10 EOM në 2/10, net 30?

15 Pikë

(b) Shumë firma që e gjejnë veten me para të tepërta (surplus) të përkohshme, i investojnë këto fonde në bono thesari. Meqenëse bonot e thesarit shpesh kanë yield-in (normën e kthimit) më të ulët se çdo letër me vlerë investimi, **pse zgjidhen ato si investime?**

5 Pikë

(c) Cilët janë pjesëmarrësit e tregut në tregun valutor?

5 Pikë

(Totali: 25 pikë)

Zgjidhje 3

a)

Për të vendosur nëse Raph Ltd duhet të ndryshojë kushtet e saj nga neto 10 EOM në 2/10, net 30, duhet të krahasojmë koston dhe përfitimet e secilës alternativë. Këtu është një analizë e hollësishme:

Kushtet aktuale (neto 10 EOM):

1. **Shitjet totale:** 10,000,000 €
2. **Shitjet me kredi (80%):** $10,000,000 \text{ €} * 80\% = 8,000,000 \text{ €}$
3. **Periudha mesatare e grumbullimit:** 60 ditë
4. **Llogaritë e arkëtueshme mesatare:** $(8,000,000 \text{ €} / 365) * 60 = 1,315,068 \text{ €}$

Kushtet e reja (2/10, net 30):

1. **60% e klientëve do të marrin zbritjen prej 2%:**
 - Shitjet me zbritje: $8,000,000 \text{ €} * 60\% = 4,800,000 \text{ €}$
 - Vlera neto pas zbritjes (2%): $4,800,000 \text{ €} * 98\% = 4,704,000 \text{ €}$
2. **40% e klientëve do të paguajnë pas 30 ditëve:**
 - Shitjet pa zbritje: $8,000,000 \text{ €} * 40\% = 3,200,000 \text{ €}$
3. **Periudha mesatare e grumbullimit e reduktuar në 40 ditë:**
 - Llogaritë e arkëtueshme mesatare: $(4,704,000 \text{ €} * 10/365) + (3,200,000 \text{ €} * 30/365) = 128,822 \text{ €} + 263,013 \text{ €} = 391,835 \text{ €}$

Kosto oportune:

1. **Kosto oportune aktuale:**
 - $1,315,068 \text{ €} * 12\% = 157,808 \text{ €}$
2. **Kosto oportune me kushtet e reja:**
 - $391,835 \text{ €} * 12\% = 47,020 \text{ €}$

Përfitimi dhe kosto shtesë nga kushtet e reja:

1. **Kosto e zbritjes:**
 - Zbritja prej 2% mbi shitjet me zbritje: $4,800,000 \text{ €} * 2\% = 96,000 \text{ €}$
2. **Kursimet nga reduktimi i periudhës së grumbullimit:**
 - Kursimet nga kosto oportune: $157,808 \text{ €} - 47,020 \text{ €} = 110,788 \text{ €}$

Vendimi:

- Kursimet nga kosto oportune (110,788 €) janë më të larta se kosto e zbritjes (96,000 €).
- Përfitimi neto nga ndryshimi i kushteve: $110,788 \text{ €} - 96,000 \text{ €} = 14,788 \text{ €}$

Duke pasur parasysh se përfitimi neto është pozitiv, Raph Ltd duhet të ndryshojë kushtet e tij nga neto 10 EOM në 2/10, net 30.

b)

Bonot e thesarit shpesh zgjidhen si investime edhe pse kanë yield-in më të ulët për disa arsye kryesore:

1. **Siguria:** Bonot e thesarit janë të garantuara nga qeveria, çka i bën ato një nga investimet më të sigurta. Në një kohë kur firma ka fonde të tepërta përkohësisht, ajo mund të preferojë sigurinë mbi kthimin e lartë për të mos rrezikuar kapitalin.
2. **Likuiditeti:** Bonot e thesarit janë shumë likuide, që do të thotë se mund të shiten lehtësisht në tregun sekondar pa humbur vlerë. Kjo i jep firmës fleksibilitet për të aksesuar fondet kurdo që ka nevojë për to.
3. **Diversifikimi:** Duke investuar në bonot e thesarit, firmat mund të diversifikojnë portofolin e tyre të investimeve. Kjo ndihmon në shpërndarjen e riskut dhe në sigurimin e stabilitetit financiar.
4. **Kostoja e ulët e transaksionit:** Investimi në bono thesari ka zakonisht kosto më të ulët të transaksionit krahasuar me investimet e tjera, çka e bën atë tërheqës për menaxhimin afatshkurtër të likuiditetit.
5. **Përmbushja e kërkesave rregullatore:** Në disa raste, firmat mund të kenë kërkesa rregullatore që i obligojnë të mbajnë një pjesë të aktiveve të tyre në investime të sigurta si bonot e thesarit.
6. **Menaxhimi i riskut të interesit:** Bonot e thesarit janë një mënyrë për të menaxhuar riskun e interesit. Nëse normat e interesit bien, vlera e bonove të thesarit rritet, duke ofruar një mbrojtje kundër ndryshimeve të pafavorshme në normat e interesit.

Këto arsye tregojnë pse firmat mund të preferojnë bonot e thesarit edhe kur kthimi është më i ulët.

c)

Në tregun valutor, ku tregtohen monedhat e ndryshme, pjesëmarrësit kryesorë janë:

1. **Bankat Qendrore:** Bankat qendrore, si Federal Reserve (SHBA), Banka Qendrore Evropiane (BQE), dhe të tjera, luajnë një rol kyç në tregun valutor. Ato ndikojnë kursin e këmbimit përmes politikave monetare dhe ndërhyrjeve direkte në treg.
2. **Bankat Komerciale:** Bankat komerciale janë ndër pjesëmarrësit më të mëdhenj në tregun valutor. Ato ofrojnë shërbime të këmbimit valutor për klientët e tyre dhe kryejnë transaksione për të menaxhuar likuiditetin dhe ekspozimin ndaj kursit të këmbimit.
3. **Institucionet Financiare:** Fondet e investimeve, fondet e pensioneve dhe fondet mbrojtëse (hedge funds) përdorin tregun valutor për të diversifikuar portofolin e tyre dhe për të mbrojtur investimet e tyre nga ndryshimet e kursit të këmbimit.
4. **Kompani Multinacionale:** Kompanitë që operojnë në shumë vende kanë nevojë të shkëmbejnë valutë për të kryer transaksione ndërkombëtare. Ato përdorin tregun valutor për të menaxhuar ekspozimin ndaj kursit të këmbimit dhe për të optimizuar fitimet.

5. **Tregtarët e Pasurive të Vërteta dhe Investitorët:** Tregtarët individualë dhe investitorët e pasurive të vërteta spekulojnë në ndryshimet e kursit të këmbimit për të realizuar fitime. Ata përdorin analiza teknike dhe fundamentale për të parashikuar lëvizjet e çmimeve.
6. **Brokerët dhe Agjentët e Këmbimit Valutor:** Brokerët dhe agjentët ndërmjetësojnë transaksionet mes pjesëmarrësve të ndryshëm në tregun valutor. Ata ofrojnë platformat dhe shërbimet e nevojshme për të kryer tregtimet dhe për të menaxhuar rreziqet.
7. **Qeveritë dhe Agjencitë Publike:** Përveç bankave qendrore, qeveritë dhe agjencitë publike mund të marrin pjesë në tregun valutor për të menaxhuar rezervat e tyre valutore dhe për të ndikuar në kursin e këmbimit të monedhës së tyre.
8. **Individët:** Individët gjithashtu marrin pjesë në tregun valutor, shpesh përmes shërbimeve të këmbimit valutor për udhëtime ose për të kryer pagesa ndërkombëtare.

Këta pjesëmarrës kontribuojnë në likuiditetin dhe funksionimin efikas të tregut valutor, duke siguruar që monedhat mund të tregtohen në çdo kohë me një kosto të arsyeshme.

Problemi 4

Kompania QABO SH.P.K. dëshiron të kalkuloj koston mesatare të ponderuar të kapitalit. Informacionet në dispozicion janë:

Numri i aksioneve të zakonshme	€20 milion
Vlera kontabël e obligacionit të konvertueshëm, me interes prej 7%	29 milion
Vlera kontabël e huas bankare me interes prej 8%	2 milion
Çmimi i tregut i aksioneve të zakonshme	€5.50 për aksion
Vlera e tregut e obligacioneve të konvert.	€107.11 për çdo €100 të vlerës nominale të obligacioneve
Koeficienti Beta i aksioneve të QABO SH.P.K.	1.2
Norma e kthimit pa rrezik	4.7%
Premia për rrezikun e ndërmarrë ($R_m - R_f$)	6.5%
Norma e tatimit në fitim (korporatës)	30%

Norma mesatare e pritur e rritjes së çmimit të aksioneve është 6% në vit. Obligacionet e konvertueshme mund të riblehen pas 8 viteve me vlerën e tyre nominale, ose mund të konvertohen pas 6 viteve në 15 aksione të zakonshme të kompanisë QABO SHPK për çdo €100 të vlerës nominale të obligacioneve. Faktori i skontimit me 10% (vitet 1 deri 6 = 4.355), viti 6 = 0.564. Faktori i skontimit me 5% (vitet 1 deri 6 = 5.076), viti 6 (0.746).

Kërkoet:

(i) Kalkuloni koston mesatare të ponderuar të kapitalit (KMPK/WACC) sipas vlerës së tregut për kompaninë QABO SHPK.

16 pikë

(ii) Diskutoni rrethanat në bazë të së cilave kosto mesatare e ponderuar e kapitalit (KMPK/WACC) mund të shfrytëzohet gjatë vlerësimit të projekteve kapitale/investive.

9 pikë

(Totali: 25 pikë)

Zgjidhje 4

(i) Kalkulimi i kostos mesatare të ponderuar të kapitalit (KMPK/WACC)

Kosto e ekuitetit (aksioneve të zakonshme)

Kosto e ekuitetit sipas modelit të vlerësimit të aseteve kapitale (CAPM) = $4.7 + (1.2 \times 6.5) = 12.5\%$

Kosto e obligacioneve të konvertueshme

Pagesa vjetore e interesit pas-tatimit = $7 \times (1 - 0.3) = €4.90$ për obligacion

Çmimi i tregut i aksioneve pas 6 viteve = $5.50 \times 1.06^6 = €7.80$

Vlera e konvertimit = $7.80 \times 15 = €117.00$ për obligacion

Konvertimi duket të jetë i mundshëm pasi që vlera e konvertimit është më e lartë sesa vlera nominale e obligacioneve.

Rrjedhat e parave në të ardhmen e cila duhen të skontojnë janë 6 pagesat e interesit pas tatimit dhe vlera e konvertimit e pranuar pas 6 viteve:

Viti	Rrjedha e parasë	€	10% Faktori	VT (€)	5% Faktori	PV (€)
0	vlera e tregut	(107.11)	1.000	(107.11)	1.000	(107.11)
1-6	interesi	4.9	4.355	21.34	5.076	24.87
6	konvertimi	117.00	0.564	66.00	0.746	87.28
				-----		----
				(19.77)		5.04
				-----		----

Duke shfrytëzuar interpolimin linear, kosto e obligacioneve pas tatimit është = $5 + [(5 \times 5.04) / (5.04 + 19.77)] = 6.0\%$.

Mund ta konfirmojmë se konvertimi është i mundshëm pasi që çmimi aktual i tregut €107.11 duke parë se çmimi dysheme i obligacioneve të konvertueshme me një kosto të obligacioneve pas tatimit prej 6% është €93.13 ($4.9 \times 6.210 + 100 \times 0.627$).

Kosto e huas bankare

Norma e interesit pas tatimit është = $8 \times (1 - 0.3) = 5.6\%$

Vlerat e tregut

Vlera e tregut e ekuitetit = $20m \times 5.50 = €110$ milion

Vlera e tregut e obligacioneve të konvertueshme = $29m \times 107.11/100 = €31.06$ milion

Vlera kontabël e huas bankare = €2m

Vlera totale e tregut = $110 + 31.06 + 2 = €143.06$ milion

KMPK (WACC) = $[(12.5 \times 110) + (6.0 \times 31.06) + (5.6 \times 2)]/143.06 = 11.0\%$

(ii) Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit (KMPK/WACC) mund të shfrytëzohet si normë skontuese gjatë vlerësimit të projekteve kapitale vetëm nëse rreziqet e projektit investues janë të ngjashme me rreziqet e kompanisë e cila është duke planifikuar të ndërmarr investimit. Në këtë rast KMPK/WACC do të reflektoj këto rreziqe do të përfaqësoj kthimin mesatar të kërkuar si kompensim për këto rreziqe. Kjo nënkupton se KMPK/WACC mund të shfrytëzohet për të

vlerësuar zgjerimin e biznesit ekzistues. Nëse rreziku biznesor i projektit investues është i ndryshëm nga rreziku ekzistues i operacioneve të kompanisë, atëherë duhet të kalkulohet norma skontuese specifike e cila i reflekton këto rreziqe. Modeli CAPM mund të shfrytëzohet për të arritur deri te një normë e tillë.

KMPK mund të përdor në një vlerësim të projektit kapital nëse rreziku financiar i projektit të propozuar është i ngjashëm me rrezikun financiar të operacioneve ekzistuese të kompanisë. Kjo nënkupton se financimi i projektit duhet të bëhet në atë mënyrë që të ruhet struktura ekzistuese e kapitalit të kompanisë. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë duhet aplikuar një metodë tjetër të vlerësimit të projekteve kapitale të quajtur vlera e korrigjuar e tanishme (APV). Në mënyrë alternative, mund të korrigjohet CAPM për të reflektuar rrezikun financiar të financimit të projektit.